



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ✓

Nr. 3457 Prot.

Tiranë, më 27. 02.2026

Lënda: Kërkesë për respektimin e të drejtave të deputetëve të pakicës parlamentare.

Drejtuar: **Z. Niko PELESHI**
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë.

Zoti Kryetar i Kuvendit,

Në seancën plenare të datës 27.07.2026, ora 10:00 u njoftua dhe miratuar (pa na e vënë në dispozicion) kërkesa e Këshillit të Ministrave për shqyrtimin me procedurë të përsheptuar të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas direkte, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përfaqësuar nga Agjencia e Bashkëpunimit për Sigurinë e Mbrojtjes (DSCA), në kuadër të financimit të jashtëm ushtarak (FMF)”.

Gjatë kësaj seance, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka informuar se, në kundërshtim me nenin 69, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, nuk janë njohur me përmbajtjen e marrëveshjes dhe relacionin shoqërues, duke cënuar kështu parimin e demokracisë përfaqësues në drejtim të ushtrimit të lirisë së shprehjes, të lidhur me debatin parlamentar, të drejtën e paraqitjes së amendamenteve dhe votimit të informuar (shih paragrafin 54, të vendimit Nr. 18, datë 23.02.2026 të Gjykatës Kushtetuese). Po ashtu, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka mbajtur qëndrimin se shqyrtimi me procedurë të përsheptuar i projektligjit brenda të njëjtës ditë, është në kundërshtim me nenin 83, pika 2, të Kushtetutës dhe nenin 28, pika 4, të Rregullores së Kuvendit (shih paragrafin 53, të vendimit Nr. 18, datë 23.02.2026 të Gjykatës Kushtetuese).

Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, në funksion të garantimit të parimit të demokracisë përfaqësuese, respektimit të të drejtave që burojnë nga statusi kushtetues i deputetëve, zbatimit të standardeve të sanksionuara nga jurisprudenca kushtetuese, në mbështetje të nenit 2, pika 2, nenit 70, pika 1, nenit 75, pika 2, nenit 82, pika 1, nenit 83, pika 2, të Kushtetutës së Shqipërisë, nenit 28, pika 3, nenit 46, pika 1, nenit 48, pika 1,

nenit 68, pika 2, nenit 69, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, nenit 4, pikat 1 dhe 3, nenit 5, të Ligjit Nr. 8850, datë 18.11.1999 “*Statusi i Deputetit*”, i ndryshuar, dhe vendimit Nr. 28, datë 23.02.2026 të Gjykatës Kushtetuese, përfundimisht:

KËRKOJMË:

1. Shpërndarjen dhe vënien në dispozicion të tekstit të marrëveshjes së huas direkte, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përfaqësuar nga Agjencia e Bashkëpunimit për Sigurinë e Mbrojtjes (DSCA), në kuadër të financimit të jashtëm ushtarak (FMF), dhe relacionit shoqërues të projektligjit, sëbashku me argumentet e dhëna nga Këshilli i Ministrave për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të këtij projektligji. Sikurse rezulton nga shkresa nr. 4705/2 Prot., datë 24.07.2026 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministarave, është kërkuar vetëm që marrëveshja të mos publikohet nga strukturat përgjegjëse të Kuvendit, sepse përmban të dhëna me natyrë tregtare dhe financiare, që konsiderohen si konfidenciale. Në asnjë rast, nga Këshilli i Ministrave dhe pala amerikane në këtë marrëveshje, nuk është kërkuar që projektligji, në kundërshtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, të mos i shpërndahet deputetëve dhe këta të fundit të votojnë të painformuar.
2. Shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit “*Për ratifikimin e marrëveshjes së huas direkte, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përfaqësuar nga Agjencia e Bashkëpunimit për Sigurinë e Mbrojtjes (DSCA), në kuadër të financimit të jashtëm ushtarak (FMF)*”, pas kalimit të afatit 1-javor, të sanksionuar nga neni 83, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 28, pika 4, e Rregullores së Kuvendit.

Përsa më lart, ju kërkojmë të zbatoni Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit.

**GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE
KRYETARI**

Gazment BARDHI

